



**REPUBLIKA E MALIT TE ZI  
KOMISIONI PER KONSTATIMIN E  
KONFLIKTIT TE INTERESAVE**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
INSPEKTORATI I LARTE I DEKLARIMIT DHE  
KONTROLLIT TE PASURIVE**

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

**Neni 1**

Ky Memorandum Bashkëpunimi përfaqëson marrëveshjen midis Komisionin për Konstatimin e Konfliktit të Interesave të Republikës së Malit të Zi dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të Republikës së Shqipërisë, për bashkëpunimin në zbatim të Ligjit mbi konfliktin e interesave të Malit të Zi dhe Ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 2**

Komisioni për Konstatimin e Konfliktit të Interesave të Malit të Zi dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të Republikës së Shqipërisë, bien dakort të bashkëpunojnë me projekte dhe veprimtari në fushën e parandalimit të konfliktit, përkatësisht konfliktit të interesave të funksionarëve publikë të zgjedhur dhe të emëruar.

**Neni 3**

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është shkëmbimi i përvojave në zbatim të ligjit sipas nenit 1 të këtij Memorandumi për arritjen e rezultateve të mira në këtë fushë.

**Neni 4**

Bashkëpunimi do të realizohet nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve dhe përvojave, vizitave studimore, trajnimeve dhe projekteve të përbashkëta, nëpërmjet organizimit të seminareve dhe konferencave, si dhe nëpërmjet realizimit të bashkëpunimit rajonal me organe të njëjta ose të ngjashme të fushës së konfliktit të interesave.

**Neni 5**

Bashkëpunimi do të kryhet nëpërmjet realizimit të projekteve të përbashkëta që kanë për qëllim trajnimin e funksionarëve dhe nëpunësve publikë për zbatimin e ligjit sipas nenit 1 të Memorandumi dhe e gjithë kjo me qëllim që të pakësohen shfaqjet ose situatat eventuale që çojnë funksionarët publikë të zgjedhur ose të emëruar në konflikt interesi, përkatësisht të frenohet korrupsioni në organet shtetërore dhe shërbimet publike, nëpërmjet informimit dhe edukimit të subjekteve potenciale të konfliktit të interesave, nëpërmjet përmirësimit të aksesit me informacione në këtë fushë.

**Neni 6**

Me qëllim të realizimit sa më efikas të projektit dhe të realizimit me anë të këtij Memorandumi të qëllimit final, Komisioni për Konstatimin e Konfliktit të Interesave të Republikës së Malit të Zi dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të Republikës së Shqipërisë do të konsultohen midis tyre dhe do të shkëmbejnë informacione relevante dhe do të bashkëpunojnë për të çuar përpara kuadrin ligjor dhe reformat e legjislacionit me të cilin do të trajtohet fusha e konfliktit të interesave.

**Neni 7**

Nënshkruar në Podgoricë, më 22 Gusht 2007, në dy ekzemplarë të njëjtë në gjuhën malazeze dhe shqipe, duke qenë tekstat në të dy gjuhët autentike.

**KOMISIONI PER KONSTATIMIN E  
KONFLIKTIT TE INTERESAVE  
I REPUBLIKES SE MALIT TE ZI**

**KREYTARI  
SLOBODAN LUKOVIC**

*S. Lukovic*



**INSPEKTORATI I LARTE I  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TE  
PASURIVE  
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

**INSPEKTOR I PERGJITHSHEM  
FATMIRA LASKA**

*F. Laska*